



Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63  
Tel: ++355 4 235 249 / 240 602 Fax: ++355 4 240 565  
kas@nocalbania.org.al / www.nocalbania.org.al



Komiteti Olimpik Kombetar Shqiptar  
[www.nocalbania.org.al](http://www.nocalbania.org.al)

# Roli dhe funksioni i Këshillit të Arbitrazhit Sportiv në Shqipëri

*"Rregullorja e KAS"*

**Erald DERVISHI**  
**Arbitër i Këshillit të Arbitrazhit Sportiv**

**Tiranë, 16 Maj 2011**

## Roli i Këshillit të Arbitrazhit Sportiv, "KAS"

- Këshilli i Arbitrazhit Sportiv, është një institucion i pavarur, kundrejt të gjitha organizatave të tjera sportive, i cili ofron shërbime, dhe ushtron funksionin e tij për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lidhura me sportin;
- Këshilli i Arbitrazhit Sportiv Shqiptar, "KAS", është krijuar fillimisht në vitin 1996, dhe përbëhet nga 10 arbitra, të cilët përvec se duhet të jenë me profesion jurist, duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 3 të Rregullores së KAS, të lidhura kryesisht me: a) Pastërtinë morale të figurës së arbitrit, b) Njohuri në të drejtën e sportit, c) Kontributin konkret të çdo arbitri në fushën e sportit.

# Organizimi i "KAS"

"KAS" përbëhet nga:

- Kryetari, i cili zgjidhet nëpërmjet votimit të hapur, mes anëtarëve të tij me shumicë votash, për një periudhë 4 (katër) vjeçare me të drejta rizgjedhjeje;
- Arbitrat;
- Seksioni i Gjykimit, i cili organizohet me trupa të përbërë nga 1 ose 3 arbitra;
- Sekretaria e "KAS".

# Baza Ligjore

“KAS” është krijuar dhe funksionon në bazë të:

- Kartës Olimpike neni 74, kreu V;
- Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, nenet 400-439;
- Ligjit nr. 9376, datë 21.04.2005 “Për sportin”, kreu V, nenet 21 dhe 22;
- Statutit të KOKSH;
- Statuteve dhe rregulloreve të anëtarëve të KOKSH;
- Konventës së New York-ut *“Mbi njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazheve”*

## Misioni dhe Parimet e "KAS"

- Misioni i "KAS" është zgjidhja e mosmarrëveshjeve/konflikteve në fushën e sportit nëpërmjet arbitrazhit. "KAS" e ushtron këtë funksion me anën e dhënies së Vendimeve të Arbitrazhit, të cilat janë të njohura nga legjislacioni shqiptar në fuqi, dhe kanë të njëjtën forcë ligjore dhe zbatueshmëri, sikur të ishte një gjykatë shtetërore;
- Gjithashtu, "KAS" ndër funksionet e tjera, ka edhe atë të ndihmojë palët, në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre në mënyrë miqësore, nëpërmjet "ndërmjetësimit", si dhe dhënies së "opinioneve" dhe "këshillave" për këtë qëllim, mbi çdo çështje të së drejtës që rregullon sportin apo zhvillimin e sportit;
- "KAS" i ushtron funksionet e tij të lartpërmendura, duke respektuar parimet e pavarësisë, konfidencialitetit dhe paanshmërisë.

## Është “KAS” një Gjykatë shtetërore?

- “KAS” nuk është një Gjykatë shtetërore, por një Institucion Arbitrazhi i njohur nga legjislacioni shqiptar në fuqi;
- Si i tillë, gjykimet pranë “KAS” bazohen në konsensusin e vetë palëve, për të zgjidhur mosmarrëveshjet/konfliktet pranë këtij Institucioni;
- Që do të thotë se “KAS”, mund të shërbejë si një trup gjykues për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve vetëm nëse ekzistojnë:
  - a) Marrëveshje/Klausolë arbitrazhi të vlefshme ndërmjet palëve në konflikt;
  - b) Statutet/Rregulloret e Federatave/Shoqatave sportive parashikojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe konflikteve pranë “KAS”.

# Mosmarrëveshjet të cilat mund të shqyrtohen nga “KAS”

Në parim, çdo mosmarrëveshje që është e lidhur në mënyrë direkte apo indirekte me sportin, mund të shqyrtohet nga “KAS”.

- “KAS” është kompetent për shqyrtimin në shkallë të parë të mosmarrëveshjeve me:
  - a) Karakter tregtar, (*ekzekutimi i kontrtave, sponsorizimi i aktiviteteve, shitja e të drejtës televizive, etj.*)
  - b) Të lidhura me përgjegjësitë civile (*aksidentimin e një sportisti, dëmtimin e pronës së klubeve sportive, apo dëmtimin e imazhit të klubeve sportive, etj.*)
  
- “KAS” është kompetent për shqyrtimin në shkallë të dytë të:
  - a) Mosmarrëveshjeve midis federatave, shoqatave, organeve të tyre drejtues, si dhe organizmave të tjerë sportivë;
  - b) Mosmarrëveshjeve të lidhura mbi masat disiplinore (*përdorimi i dopingut apo substancave të tjera të ndaluara, shkeljet disiplinore përgjatë aktiviteteve sportive, etj.*)

## Kush mund t'i drejtohet "KAS"?

- Çdo person fizik apo juridik, i cili ka zotësi juridike për të vepruar mund t'i drejtohet Këshillit të Arbitrazhit Sportiv, dhe të marrë shërbimet e lartpërmendura.
- Këtu përfshihen sportistët, klubet, federatat sportive, organizuesit e aktiviteteve sportive, sponsorizuesit, kompanitë televizive, etj.



## Legjislacioni i zbatueshëm nga “KAS”

- Këshilli i Arbitrazhit Sportiv Shqiptar “KAS” zbaton legjislacionin shqiptar në shqyrtimin e mosmarrëveshjeve pranë këtij institucioni, bazuar kjo, dhe në Nenin 427 të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

## Avantazhet e zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve pranë "KAS"

- Shpenzime të reduktuara të procesit të arbitrazhit (*kosto të ulëta*), në raport me një proces normal gjyqësor;
- Shpejtësi më e madhe e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, në raport me një proces normal gjyqësor;
- Konfidencialiteti;
- Profesionalizmi i arbitrave të KAS, dhe njohja e thelluar e legjislacionit mbi sportin;
- Sensibiliteti më i madh i arbitrave të "KAS", ndaj problemeve të sportit.

## Jurisdiksioni i "KAS" dhe moskompetenca e gjykatave të tjera

- "KAS", mund të shërbejë si një trup gjykues për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve vetëm nëse ekzistojnë:
  - a) Marrëveshje/Klausolë arbitrazhi të vlefshme ndërmjet palëve në konflikt;
  - b) Statutet/Rregulloret e Federatave/Shoqatave sportive parashikojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe konflikteve pranë "KAS".
- Ekzistenca e një marrëveshje/klausole arbitrazhi pranë "KAS", përjashton mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve nga jurisdikSIONET (*gjykatat*) e tjera;
- JurisdikSIONET e tjera duhet të deklarojnë moskompetencën e tyre (neni 414 i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë).

## Ngritja e padisë pranë "KAS"

- Mosmarrëveshje/konflikt midis palëve;
- Ekzistenca e një marrëveshjeje/klausole arbitrazhi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve pranë "KAS";
- Ngritja e padisë nga njëra prej palëve të interesuara pranë "KAS".

## Përcaktimi i trupës së Arbitrazhit, përzgjedhja e arbitrave

- Trupat e arbitrazhit të "KAS" përbëhen nga 1 ose 3 arbitra;
- Nëse marrëveshja/klausola e arbitrazhit nuk përcakton numrin e arbitrave, Kryetari i "KAS" përcakton numrin e arbitrave duke marrë parasysh ceshtjet që janë në shqyrtim;
- Trupa e arbitrazhit me një arbitër: palët me konsensus mes tyre caktojnë arbitrin brenda 15 ditëve. Nëse palët nuk bien dakort, Kryetari i "KAS" cakton arbitrin;
- Trupa e arbitrazhit me 3 arbitra: secila palë cakton nga një arbitër brenda afateve të përcaktuara, dhe nëse palët nuk caktojnë arbitrat, Kryetari i "KAS" cakton arbitrat në vend të palëve;
- Drejtuesi i trupit të Arbitrazhit zgjidhet me konsensusin e 2 arbitrave të caktuar, nëse këta të fundit nuk bien dakort, Kryetari i "KAS" cakton Drejtuesin e Trupit të Arbitrazhit.

# Vendimet e "KAS" dhe ekzekutimi i tyre

- Vendimet e "KAS" janë të formës së prerë në lidhje me mosmarrëveshjen e shqyrtuar (neni 432 i Kodit të procedurës Civile);
- Vendimet e "KAS" bëhen të ekzekutueshëm forcërisht në bazë të një Urdhëri ekzekutimi të lëshuar nga Gjykata e Shkallës së Parë, Tiranë, (neni 432 i Kodit të procedurës Civile);
- Për këtë qëllim, në sekretarinë Gjykatës depozitohet origjinali i vendimit të "KAS", e shoqëruar nga një kopje e marrëveshjes/klausolës së arbitrazhit;
- Urdhrit të ekzekutimit i bashkangjitet origjinali i vendimit të "KAS";
- Kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, që lëshon urdhër ekzekutimin nuk lejohet ankim.

## Ankimi kundër vendimeve të "KAS"

- Vendimet e "KAS" janë të formës së prerë dhe janë përgjithësisht të paankimueshme, duke përjashtuar këtu vetëm rastet e përcaktuara shprehimisht në nenin 434 të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, dhe që kanë të bëjnë me:
  - a) Trupa e arbitrazhit është formuar në mënyrë të parregullt;
  - b) "KAS" pa të drejtë ka deklaruar kompetencën e tij për gjykimin e mosmarrëveshjes;
  - c) "KAS" në vendimin e saj tejkalon kërkesat për të cilat është investuar, ose nuk është shprehur mbi një nga kërkesat kryesore të padisë;
  - d) Nuk është respektuar barazia e palëve dhe e drejta e tyre për t'u dëgjuar në një procedurë të mbështetur në parimin e kontradiktoritetit;
  - e) Vendimet e "KAS" bien në kundërshtim me rendin publik në Republikën e Shqipërisë.
- Vetëm në rastet e lartpërmednura lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit, Tiranë, brenda 30 ditëve nga dita e shpalljes së vendimit.

## Konventa e New York-ut, ratifikimi dhe implementimi i saj në Republikën e Shqipërisë

- Republika e Shqipërisë firmos dhe ratifikon Konventën e New York-ut "*Mbi njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të gjykatave të arbitrazhit*", në vitin 2001;
- Konventa e New York-ut, përcakton detyrimin e çdo shteti anëtar që të njohë dhe të ekzekutojë vendimet e gjykatave të arbitrazhit të shteteve të tjera;
- Gjithashtu, kjo Konventë, përcakton detyrimin e çdo shteti anëtar, që të njohë dhe të ekzekutojë vendimet e gjykatave të arbitrazhit brenda shtetit të tyre.



Faleminderit për vëmendjen Tuaj!

*Pyetje?*

*Website: [www.kas@nocalbania.org.al](mailto:www.kas@nocalbania.org.al)*